

Laci/ Alfred Zefi te henen i nenshtrohet operacionit

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 28 Nentor 2013 02:43



Futbollisti i Laci Alfred Zefi do tii nenshtrohet nje operacioni ne pjesen e poshtme te syrit ne (mollzen e majte). Nje vendim i tille sic pohon vete futbollisti ka ardhur pas kontrollit te dyte te bere dite e marte paradite ne spitalin “Nene Tereza”, ne kryeqytet. Nderhyrja kirurgjikale do te behet ne oret e para te paradites dite e hene ne sipalin “Nene Tereza”. Akoma nuk dihet se sa do te zgjase koha e qendrimit jashte fushave per futbollistin. Ka te ngjare se mesfushori i njohur i kesaj skuadreje pas periudhes se rikpuperimit mund te luaje dhe me maske mbrojtese, duke u bere futbollistin e dyte ne kampionat pas E.Mucollarit te Kastriotit, i cili per koicidence eshte demtuar ne te njejtin vend ne fytyre ne ndeshjen ndaj Tiranës ne fazen e pare ne kryeqytet.